



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E FINANCEVE
DREJTORIA E PERGJITHSHME E THESARIT
Drejtoria e Kontabilitetit dhe Raportimit Financiar

Nr.12222 Prot.

Tirane me11/11/2009

U R D H E R

Nr. 35 date 11/11/2009

PER MIRATIMIN E FATURES PER ARKETIM

Ne mbeshtetje te Ligjit te Buxhetit e te Udhezimeve ne zbatim te tij si dhe ne kuader te implementimit te sistemit te informatizuar te Thesarit, me propozim te Drejtorise se Pergjithshme te Thesarit ;

Urdheroj :

1. Perdorimin e - **Fatures per arketim** - sipas modelit qe i bashkelidhet ketij urdheri dhe qe miratohet me kete urdher.
2. **Faturen per arketim** – e hartojne, vetem ne perputhje me kete format, te gjitha institucionet buxhetore qe presin te perfitojne te ardhura jo tatimore dhe te ardhura nga taksat lokale nga kliente (persona / persona fizik / persona juridik).
3. Institucioni ploteson saktesisht, Emrin e Bankes se nivelit te dyte ku adresohet, emrin dhe kodin e institucionit te vet, emrin dhe kodin e Deges se Thesarit ku vepron, pershkrimin e te ardhurave qe priten te arketohen, kodin shtatshifror te llogarise ekonomike te te ardhurave qe priten te arketohen, shumen e te ardhurave qe priten te arketohen.
4. Per arketimin e te ardhurave klientet fillimisht paraqiten ne institucion per te terhqur – **Faturen per Arketim** – ose e shkarkojne ate nga faqja e internetit e Ministrive apo institucioneve te linjes dhe ne faqen e internetit te Ministrise se Financave.
5. Pasi fatura e plotesuar nenshkruset nga perfaqesuesi i institucionit dhe klienti, nje kopje e saj mbetet ne institucion dhe nje kopje i jepet klientit per kryerjen e veprimeve te arketimit ne banken e nivelit te dyte te adresuar.
6. Banka e nivelit te dyte do te pranoje arketime te te ardhurave jo tatimore nga kliente (persona / persona fizik / persona juridik) vetem ne se klienti paraqet kete fature. Banka pasi e shikon te rregullt, pranon arketimin dhe sponton te ardhuren ne kutizat perkatese te cepit te djathte te fatures.
7. Per zbatimin e ketij Urdheri ngarkohen te gjitha Institucionet Buxhetore, Ministrite dhe Institucionet e tjera Qendrore te linjes, Drejtoria e Kontabilitetit dhe Raportimit Financiar dhe Drejtoria e Pergjithshme e Teknologjise se Informacionit ne Ministrine e Financave.

Ridvan BODE

MINISTER

Konceptuan ; Enver KALEMASI,

Mimoza PEÇO

Konfirmoi; Ylber BEZO,